

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Biljana Rexhiq, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit, I.G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 pa.r 2 lidhur me par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1502/2013, të datës 31.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 27.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1502/2013, të datës 31.10.2016, **vërtetohet**.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht në kuptim të nenit 150 par 1 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1502/2013, të datës 31.10.2016, është shpallur fajtor i akuzuari, I.G., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par 2 lidhur me par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 3 (tri) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej 20,44 €, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.35/2017, të datës 18.01.2017, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, nuk është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të vendimit për dënimin, duke theksuar se dënimi i shqiptuar është i ulët në raport me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit. Gjykata e shkallës së parë i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, sikurse janë ato se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se është mbajtës i vetëm i familje, se ka patur qëndrim korrekt në gjykatë, ndërsa rrethana rënduese ka theksuar se nuk ka gjetur, mirëpo është dashur që të ketë parasysh dhe të vlerëson rrethanën, se për kryerjen e kësaj vepre penale, ka ardhur në shprehje dashja e të akuzuarit, dhe se i njëjti me paramendim dhe vetëdije të plotë e ka kryer këtë vepër penale duke e kanosur disa herë dhe në mënyrë sistematike të dëmtuarin-zyrtarin policorë Sh.N., dhe atë pranë objektit të Stacionit Policorë, dhe duke përdorur dhunë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur sjellje korrekte në gjykatë, se i njëjti është kryefamiljarë, gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, sikurse janë mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, mirëpo pretendimet ankimore nga ana e prokurorisë se me dashje e ka kryer veprën penale, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se dashja është element i kryerjes së veprës penale, dhe e njëjta nuk mund të merret si rrethanë rënduese, ngase veprat penale kryen ose me dashje ose nga pakujdesia.

Gjithashtu kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar se nga ana e gjykatës së shkallës së parë është vepruar në mënyrë të drejtë sidomos kur është vlerësuar koha e kryerjes së veprës penale deri në vendosje, andaj, në prani të këtyre rrethanave e duke mos gjetur

ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, kolegji ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në kuptim të nenit 150 par 1 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve penale, mbikëqyrjen e zbatimit të dënimit me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.10/2017 të datës 27.02.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Biljana Rexhiq